

AKT THEMELIMI

TOP TIRE

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot, me date 13/01/2025, ne Durres, Z. Petrit Bibaj, person me shtetesi Kosovare, i datelindjes 27/07/1995, mbajtes i dokumentit te identifikimit pasaporte me numer personal 1170215270 dhe numer dokumenti P01595487, me zotesi te plote juridike per te vepruar, nenshkruan kete akt themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar TOP TIRE

Neni 1

Forma e shoqerise

Ortaket themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e tyre eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte TOP TIRE

Neni 3

Baza juridike

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e statutit dhe aktiti te themelimit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

4.1 Veprimtaria e shoqerise TOP TIRE do te kete per objekt:

Import-eksport dhe tregtim me shumice brenda vendit te gomave te te gjitha llojeve.

Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport, pjese kembimi dhe pajisje per automjetet e te gjitha llojeve.



Import-eksport, shperndarja dhe tregtimi me shumice i te gjithë artikujve, mallrave dhe lendeve te para te te gjitha llojeve qe nuk ndalohen nga legjislacioni Shqiptar dhe ai nderkombetar.

Dhenie me qera te ambienteve te ndertesës.

Import te automjeteve, blerje te automjeteve brenda vendit, shitjen e tyre brenda dhe jashte vendit. Dhenie me qera te automjeteve tek te tretet.

Ndermjetesimi ne tregtine e pjeseve dhe pajisjeve te automjeteve te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit.

Tregtim te vajrave lubrifikante.

Me vendim te ortakeve te shoqërisë mund të marrë pjesë në veprimtari bashkëpunimi me shoqëri të tjera vendase apo të huaja për realizimin e projekteve të fushave të ndryshme të

biznesit.

Shoqëria gjithashtu mund te kryejë te gjitha aktivitetet e tjera te cilat jane te lejuara sipas kerkesave te legjislacionit shqiptar në fuqi

4.2 Për të arritur qëllimin e lartpërmendur, Shoqëria ka të drejtë:

Të lidhë të gjitha llojet e kontratave ose marrëveshjeve me personat fizikë ose me personat juridikë publike dhe privatë, shoqëritë, shtetin dhe subjektet e huaja ose shqiptare;

Të themelojë të gjitha llojet e shoqërive ose të marrë pjesë në shoqëritë shqiptare ose të huaja, sipërmarrje të përbashkëta ose lloje të ndryshme biznesesh, që kanë objekte të njëjta ose të ngjashme; Të hapë degë ose agjenci në Shqipëri ose jashtë saj;

Të përfaqësojë bizneset shqiptare ose të huaja që lidhen me objektin e Shoqërisë;

Të lidhë marrëveshje kredie, të pranojë garanci personale ose të tjera, të marrë përsipër detyrime, të emetojë drafte, kambiale, çeqe ose letra te tjera me vlerë të kolateralit;

Të ndërmarrë ndonjë aktivitet tregtar ose aktivitet tjetër dhe të kryejë çdo veprim ligjor ose transaksion që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e Shoqërisë, ose që synon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi përmbushjen e objektit të Shoqërisë.

4.3 Shoqëria mund të kryejë në mënyrë dytësore dhe në çdo rast me qëllim arritjen e objektivave të Shoqërisë, çdo veprim tregtar, industrial, financiar dhe transaksion në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat janë të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektivave të Shoqërisë.

4.4 Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimtaritë ndihmëse, si dhe të gjitha aktivitetet e nevojshme ose të përshtatshme për të arritur qëllimin e biznesit të Shoqërisë në përputhje me ligjin.

4.5 Objekti i Shoqërisë mund të modifikohet ose ndryshohet me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 5

Selia

Shoqëria TOP TIRE e ka selinë në adresën:

Durrës, Rruga Aleksander Goga, Zona Kadastrale 8511, Numer Pasurie 30/223-N13, Kodi Unik 8511044086.

Neni 6

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

Neni 7

Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) leke.



Neni 8

Administrimi

Administrator i shoqerise do te jete:

Z. Petrit Bibaj , person me shtetesi kosovare, i datelindjes 27/07/1995 , mbajtes i dokumentit te identifikimit lejeqendrimi me numer personal J53727008K dhe numer dokumenti 839397445. Afati i emerimit te administratorit do te jete per nje periudhe 5 vjecare nga data 13/01/2025 deri me date 12/01/2030.

Neni 9

Viti financiar

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe do te mbyllet ne fund te vitit perkates.

Neni 10

Te ardhurat neto

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapital. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo viti ushtrimor, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas shlyerjes se detyrimeve tatimore dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne pasqyrat dhe raportet financiare tec do viti financiar, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise, ose mund te rrinvestohen si kapital i shoqerise.

Neni 11

Juridiksioni

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e tyre jane gjykatat shqiptare.

Ky akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar TOP TIRE eshte hartuar ne 5 kopje ne gjuhen shqipe dhe pasi lexohet, nenshkruhet nga ortaket themelues.



ORTAK I VETEM I SHOQERISE

TOP TIRE

PETRIT BIBAJ

PETRIT BIBAJ

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized 'P' followed by a series of loops and a final downward stroke.